REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr./Br./No. 1083
Data/Datum/Tarih 28.07.2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI**

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në pajtim me nenin 13 të ligjit nr. 03/L-040 për Vetеqeverisjen lokale ('Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 16-126211 të datës 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet ne Statut, 01.nr.016-28448 të dt: 22.03.2018, nxjerrë këtë:

# VENDIM

(Mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me nr. 556/23 të datës: 10.05.2023)

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit me nr. 556/23 të datës 10.05.2023 për emërimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencionimin e bizneseve START – UP për të rinjtë e Komunës së Gjilanit dhe bizneseve me pronare gra.

2. Neni 2, i Vendimit i cili ka të bëjë me vlerësimin e ofertave për bizneset START – UP për të rinjtë, konkretisht paragrafi 2.2 ndryshohet, anëtarja Eljesa Rashiti zëvendësohet me anëtaren Ajsun Abdullahu Sadiku si dhe paragrafi 2.5. Fitore Sherifi zëvendësohet me anëtaren Arta Hasani.

3. Neni 2, i Vendimit i cili ka të bëjë me vlerësimin e ofertave për Bizneset për Gra, paragrafi 1 ndryshohet, konkretisht Fatlum Xhaçkaj – Kryesyesi zëvendësohet me anëtarën Eljesa Rashitin si dhe paragrafi 5 ndryshohet, anëtarja Fitore Sherifi zëvendësohet me anëtaren Arta Hasani.

4. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit nr. 556/23 e datës: 10.05.2023.

5. Ky vendim hynë në fuqi me aktin e nënshkrimit dhe protokollimit.

Vendimi i dorzohet;
- anëtarëve të komisionit,
- arkivit ;

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyseni**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
02 Nr/Br/Sb 556
Data/Datum/Tarih 10.05.2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018 të nenit 7 dhe nenit 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.2/2018, 01 nr.016-28468 të dt.22.03.2018 si dhe në zbatim të vendimit të Kuvendit të Komunës nr.01/016-42275 të dt.27.04.2023, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për subvencionimin e bizneseve START-UP për të rinjtë e Komunës së Gjilanit dhe bizneseve me pronare gra.

2. Komisioni ka këtë përbërje:

    **2.1.** Fatlum Xhaçkaj, kryesues - NKK
    **2.2.** Eljesa Rashiti, anëtare -ZKK
    **2.3.** Donika Kajtazi -Musliu, anëtare -DZHE
    **2.4.** Besart Selimi, anëtar-ZKK
    **2.5.** Fitore Sherifi, anëtare-DZHE

3. Detyrat e Komisionit si në pikën 1 të këtij vendimi, janë përcaktuar në nenit 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.2/2018, 01 nr.016-28468 të dt.22.03.2018.

4. Komisioni për punën e tij do t'i raportojë me shkrim Kryetarit të Komunës.

5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim njoftohen:
- Anëtarët e komisionit
- DZHE dhe
- Arkivi

Kryetari i Komunës
Alban Hyseni

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOSOVA CUMHURIYETI · REPUBLIKA KOSOVA · KOMUNA E GJILANIT · OPŠTINA GNJILANE · GILAN BELEDIYESI